REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 946/20
Datë/Datum 10.12.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

PSH.nr.946/20

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje të Blerim Dina - Kryetar, Nuhi Paçarizi - Referues, Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik "Termomontimi" SH.P.K-Prishtinë, kundër B58 njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe B42 Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i pllafoneve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së" Lot 1 me nr. të prokurimit: 701-20-4645-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Qendra Klinike Universitare e Kosovës", më datën: 09.12.2020, mori këtë:

V E N D I M

I. <u>APROVOHET</u>, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: "Termomontimi "SH.P.K-Prishtinë, kundër B58 njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe B42 Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i pllafoneve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së" Lot 1 me nr. të prokurimit: 701-20-4645-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Qendra Klinike Universitare e Kosovës".

II <u>ANULOHET</u>, njoftimi per dhënie te kontratës të autoritetit kontraktues QKUK për aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i pllafoneve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së" Lot 1 me nr. të prokurimit: 701-20-4645-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Qendra Klinike Universitare e Kosovës", dhe lënda kthehet në **rivlerësim per Lot 1.**

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues "Termomontimi "SH.P.K-Prishtinë, i aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Operatori ekonomik ankues "Termomontimi" SH.P.K-Prishtinë, si palë e pa kënaqur ka deponuar ankesë në OSHP, me 16.11.2020 me nr. 946/20, kundër B58 njoftim mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe B42 Letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Renovimi i pllafoneve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së" Lot 1 me nr. të prokurimit: 701-20-4645-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- "Qendra Klinike Universitare e Kosovës", duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin: 7, 28, 52, 59, 60 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

Organi Shqyrtues i Prokurimit, konfirmon nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 18.11.2020, ka autorizuar ekspertin shqyrtues të prokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti shqyrtues i prokurimit në raportin e dt: 27.11.2020, lidhur me pretendimin ankimore të OE-ankues sqaron si në vijim:

Pretendimin nr. 1

Lidhur me pretendimin e OE "Termomontimi" SH.P.K. Zona Industriale Prishtinë i eliminuar- refuzuar për këto arsye: Në njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesa 3 Lot-I Certifikatat ISO për - ISO 14644-1 klasa e 4 - emetimi i pluhurit për pllafonin e lëshuar antibakterial -F30 -F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 1350 I sipas certifikimit Rezistenca ndaj zjarrit. Pas shkarkimit të dosjes së tenderit dhe analizës së paramasës kemi vërejtur se për pllafonin e lëshuar, si material referent, është përdorur produkti Armstrong e prodhuar nga kompania KNAUF AMF. Me këtë rast, ne si operator ekonomik, Termomontimi SH.P.K., dokumentet e dosjes së tenderit, Renovimi i plafonëve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së, i kemi përgatitur në bashkëpunim me përfaqësuesin e kompanisë KNAUF AMF, z. Ales Gabrovsek. Fillimisht në kemi kontaktuar me departamentin e informacionit të KNAUF AMF, dhe pastaj ata kanë zgjedhur përfaqësuesin e tyre, z. Ales Gabrovsek, që njëkohësisht është

edhe menaxher i shitjes për zonën e Adriatikut. Të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit, F30 - F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 13501 dhe ISO 14644-1 , dhe të dorëzuara nga ana jonë janë dokumente autentike dhe mund të sigurohen vetëm përmes komunikimit me prodhuesin. Para se të na lejohet qasja në këto dokumente nga ana e KNAUF AMF ne është nevojitur të dërgojmë certifikatën e biznesit si dhe dosjen e tenderit. Të bashkangjitur po ju dërgoj historikun e bashkëbisedimit në mes nesh dhe z. Ales Gabrovsek. Ne deklarojmë më përgjegjësi të plotë si dhe ju sigurojmë se certifikatat e dorëzuar për F30 -F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 13501 dhe ISO 14644-1 janë të vetmet dhe nuk ekzistojnë certifikata tjera për prodhuesin e armstrong AMF Knauf.

Përgjigje në pretendimin nr. 1

Ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimin ankimor nr. 1 të parashtruar nga "Termomontimi" SH.P.K. Prishtinë ankues, duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që kam pranuar në shqyrtim si dhe shkresat e dorëzuar nga Operatori ekonomik në bazë të kërkesë për informata sqaruese të kërkuara nga autoriteti kontraktues me datën 07.10.2020, përmes e-prokurim, Operatori ekonomik i prezanton të gjitha sqarimet e kërkuara si dhe e dorëzon dokumentacionin e kërkuar: Certifikatën për ISO 14644-1 klasa e 4 - emetimi i pluhurit për plafonin e lëshuar antibakterial -F30 -F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 13501 sipas certifikimit Rezistenca ndaj zjarrit, dokumentacion i cili është i kërkuar në bazë të kërkesës së kërkuar me Njoftimin për Kontratë dhe është provë e mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyron gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertit Shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa: "TERMOMONTIMI" SH.P.K. - Prishtinë ankues të merret si e bazuar. Andaj dhe rekomandojmë që Autoriteti Kontraktues të bëjë ANULIMIN e B42 Letrën standarde për tenderuesit e eliminuar dhe lënda të kthehet në **Ri-vlerësim.**

Vërejtje: Autoriteti Kontraktues "QKUK" me formularin B58- NJOFTIM MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES nuk ka bërë ANULIMIN e aktivitetit të prokurimit: "Renovimi i plafonëve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së LOT-1" pasi që të gjithë tenderuesit i ka shpallë të papërgjegjshme.

Organi shqyrtues i prokurimit i ka njoftuar palët me datë: 27.11.2020 me raportin e ekspertizës.

Seanca dëgjimore është mbajtur me datën: 09.12.2020, pa praninë e palëve konform nenit 24.1 të Rregullores së OSHP-së, e ku janë shqyrtuar shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues të prokurimit dhe të gjithë parashtresat e palëve në procedurë.

Lidhur me pretendimin e OE "Termomontimi" SH.P.K. Zona Industriale Prishtinë i eliminuar- refuzuar për këto arsye: Në njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit është kërkuar: Kërkesa 3 Lot-I Certifikatat ISO për - ISO 14644-1 klasa e 4 - emetimi i pluhurit për pllafonin e lëshuar antibakterial -F30 -F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 1350 I sipas certifikimit Rezistenca ndaj zjarrit. Pas shkarkimit të dosjes së tenderit dhe analizës së paramasës kemi vërejtur se për pllafonin e lëshuar, si material referent, është përdorur produkti Armstrong e prodhuar nga kompania KNAUF AMF. Me këtë rast, ne si operator ekonomik, Termomontimi SH.P.K., dokumentet e dosjes së tenderit, Renovimi i plafonëve dhe elementeve hidrosanitare në klinikat e QKUK-së, i kemi përgatitur në bashkëpunim me përfaqësuesin e kompanisë KNAUF AMF, z. Ales Gabrovsek. Fillimisht në kemi kontaktuar me departamentin e informacionit të KNAUF AMF, dhe pastaj ata kanë zgjedhur përfaqësuesin e tyre, z. Ales Gabrovsek, që njëkohësisht është edhe menaxher i shitjes për zonën e Adriatikut. Të gjitha dokumentet e kërkuara në dosjen e tenderit, F30 - F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 13501 dhe ISO 14644-1 , dhe të dorëzuara nga ana jonë janë dokumente autentike dhe mund të sigurohen vetëm përmes komunikimit me prodhuesin. Para se të na lejohet qasja në këto dokumente nga ana e KNAUF AMF ne është nevojitur të dërgojmë certifikatën e biznesit si dhe dosjen e tenderit. Të bashkangjitur po ju dërgoj historikun e bashkëbisedimit në mes nesh dhe z. Ales Gabrovsek. Ne deklarojmë më përgjegjësi të plotë si dhe ju sigurojmë se certifikatat e dorëzuar për F30 -F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 13501 dhe ISO 14644-1 janë të vetmet dhe nuk ekzistojnë certifikata tjera për prodhuesin e armstrong AMF Knauf.

Paneli Shqyrtues konform ekspertit shqyrtues sqaron se në lidhje me pretendimin ankimor të parashtruar nga "Termomontimi" SH.P.K. Prishtinë ankues, duke u bazuar në faktet e prezantuar në dokumentacionin që është pranuar në shqyrtim, si dhe shkresat e dorëzuar nga Operatori ekonomik në bazë të kërkesë për informata sqaruese të kërkuara nga autoriteti kontraktues me datën 07.10.2020, përmes e-prokurim, Operatori ekonomik i prezanton të gjitha sqarimet e kërkuara si dhe e dorëzon dokumentacionin e kërkuar: Certifikatën për ISO 14644-1 klasa e 4 - emetimi i pluhurit për plafonin e lëshuar antibakterial -F30 -F90 sipas DIN 4102 REI30 - REI90 sipas EN 13501 sipas certifikimit Rezistenca ndaj zjarrit, dokumentacion i cili është i kërkuar në bazë të kërkesës së kërkuar me Njoftimin për Kontratë dhe është provë e mjaftueshme

që në mënyrë të arsyeshme pasqyron gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë. Prandaj bazuar në dëshmitë e lartpërmendura rezulton se ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Paneli Shqyrtues duke u bazuar në shkresat e lëndës dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues, vjen në përfundim se autoriteti kontraktues duhet ta kthej këtë lëndë në rivlerësim dhe të bëjë ekzamnimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së dhe duke u bazuar në kriteret e përcaktuara në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në dispozitë të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Paneli Shqyrtues

Blerim DINA

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK "Qendra Klinike Universitare e Kosovës";

1x1 OE "Termomontimi"SH.P.K –Prishtinë;

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.